



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
ГЈУКТА КУШТЕТУЕСЕ
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Priština, 5. decembar 2016. godine
Br. ref.:RK1009/16

РЕШЕЊЕ О НЕПРИХВАТЉИВОСТИ

у

слуčaju br. KI156/15

Подносилац

Svetislav Stojković

**Ocena ustavnosti presude Pml. br. 217/2015 Vrhovnog suda
od 10. novembra 2015. godine**

USTAVNI SUD REPUBLIKE KOSOVO

у сastаву:

Arta Rama-Hajrizi, председница
Ivan Čukalović, заменик председника
Altay Suroy, судија
Almiro Rodrigues, судија
Snezhana Botusharova, судија
Bekim Sejdiu, судија
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, судија и
Gresa Caka-Nimani, судија

Подносилац захтева

1. Zahtev je podneo Svetislav Stojković iz Štrpca (у даљем тексту: подносилац захтева), кога заступа Goran Milenković, advokat из Štrpca.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kérkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 217/2015, të 10 nëntorit 2015, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PA1 nr. 229/2015, të 25 majit 2015 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, K. nr. 129/2013, të 4 dhjetorit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të përmendura më lart, të lëshuara nga gjykatat e rregullta të Kosovës.
4. Parashtruesi i kérkesës pretendon se është shkelur nen 24 [Barazia Para Ligjit], nen 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 13 [E Drejta për Zgjidhje Efektive] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 28 dhjetor 2015, parashtruesi i kérkesës e dorëzoi kérkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).
7. Më 22 janar 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrties, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi (gjyqtarë).
8. Më 18 shkurt 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kérkesës dhe një kopje e saj iu dërgua Gjykatës Supreme.
9. Më 20 tetor 2016, Kolegji shqyrties shqyrtoi raportin e gjyqtarit rapportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kérkesës.

Përbledhja e fakteve

10. Më 23 korrik 2013, prokurori publik në Ferizaj ngriti aktakuzën kundër parashtruesit të kérkesës, duke e akuzuar për kryerje të veprës penale të dëmtimit të varreve ose kufomave nën nenin 421.1 të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPK).
11. Më 23 korrik 2013, parashtruesi i kérkesës e paraqiti kérkesën në Gjykatën Themelore në Ferizaj, për hedhjen poshtë të aktakuzës. Ndër të tjera, parashtruesi i kérkesës pohoi se aktakuza ishte e bazuar në supozime,

pretendime arbitrale dhe ngjarje të imagjinaura, pa ndonjë provë materiale ose bazë juridike.

12. Më 4 dhjetor 2014, Gjykata Themelore në Ferizaj me Aktgjykimin K. nr. 129/2013 e shpalli parashtruesin e kérkesës fajtor për kryerjen e veprës penale të dëmtimit të varreve dhe kufomave, sipas nenit 421.1 të KPK-së. Parashtruesi i kérkesës u dënuar me burg në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh. Ndër të tjera, Gjykata Themelore mbështeti vendimin për shpalljen fajtor të parashtruesit të kérkesës, duke u bazuar në disa dëshmi të dëshmitarëve, fotografive të vendit të ngjarjes ku kishte ndodhur vepra penale dhe vetëdijes së parashtruesit të kérkesës për kryerjen e veprës penale.
13. Më 20 janar 2015, parashtruesi i kérkesës e parashtroi ankesën në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykit të Gjykatës Themelore të përmendur më lart, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vërtetimit të gabuar të së drejtës materiale, si dhe për shkak të shkeljes së procedurave ligjore. Ndër të tjera, parashtruesi i kérkesës pretendonte se: (i) ai nuk mund t'i përcillte procedurat në Gjykatën Themelore në gjuhën e tij, (ii) Gjykata Themelore nuk i kishte marrë parasysh argumentet dhe provat e sjella nga parashtruesi i kérkesës dhe (iii) Gjykata Themelore nuk vendosi mbi vërtetësinë e provave në bazë të të cilave parashtruesi i kérkesës është shpallur fajtor.
14. Më 25 maj 2015, Gjykata e Apelit, me Aktgjykimin PA1 nr. 229/2015, e refuzoi ankesën e parashtruesit të kérkesës dhe vërtetoi aktgjykit e Gjykatës Themelore.
15. Sa i përket ankesës së parashtruesit të kérkesës se procesverbali i Gjykatës Themelore nuk i ishte dorëzuar atij në gjuhën e tij amtare, në pjesën përkatëse të Aktgjykit të Gjykatës së Apelit theksohet se:

“Pretendimi i të pandehurit në ankesë se gjatë shqyrtimit gjyqësor atij i është mohuar e drejta për përdorimin e gjuhës së vet amtare, sipas vlerësimit të kësaj gjykate është i pabazuar, sepse nga shkresat e lëndës dhe në bazë të shqyrtimit të procesverbalit fillestar K. nr. 129/13, të datës 16.10.2014, procesverbalit të dytë të datës 20.11.2014, procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të datës 27.11.2014, si dhe procesverbalit të datës 04.12.2014, është vërtetuar dhe konfirmuar se në të gjitha këto seanca ka qenë i pranishëm përkthyesi gjyqësor A. Z. dhe se i pandehuri e ka ndjekur në mënyrë të plotë rrjedhën e gjykimit, ku edhe është vërtetuar se në lidhje me secilën shkresë të lëndës, kur është kërkuar nga ai, i është mundësuar ndjekja në gjuhën e tij amtare, e të gjitha këto konfirmohen me nënshkrimin e përkthyesit gjyqësor A. Z. dhe nënshkrimet e të pandehurit se nuk ka vërejtje. Domethënë, nga këto prova vërtetohet fakti se gjykata ka vepruar në pajtim me nenin 14 të KPPK-së, duke siguruuar që i pandehuri të përdorë dhe të flasë gjuhën e vet amtare dhe të jetë i informuar përmes përkthimit me provat e administruara dhe gjatë zhvillimit të procedurës, prandaj në këtë çështje penale nuk ka pasur shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga nen 384 par. 1 pika 1.3 të KPPK-së të theksuara me ankesën e mbrojtësit të të pandehurit”.

16. Sa i përket parimit kundërshtues dhe të drejtës së parashtruesit të kërkesës për të paraqitur prova dhe argumente në favor të tij, në pjesën përkatëse të Aktgjykit të Gjykatës së Apelit theksohet se:

“Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, qasja e gjykatës së shkallës së parë ndaj provave të administruara, domethënë edhe ndaj faktave vendimtare ka qenë e drejtë dhe e ligjshme. Për këtë arsy, një qëndrim të tillë të gjykatës së shkallës së parë e pranon edhe kjo gjykatë, sepse arsyet e paraqitura në arsyetimin e aktgjykit të atakuar, si ato faktike, ashtu edhe ato juridike, i pranon edhe kjo gjykatë. Gjykata e shkallës së parë e ka bërë vlerësimin e provave të administruara në pajtim me dispozitën e nenit 361 të KPPK-së dhe në bazë të vlerësimit të tillë i ka nxjerrë përfundimet e veta. Prandaj, edhe mbrojtja e të pandehurit ka qenë objekt i vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë në kontekstin e të gjitha provave të tjera. Ajo ka vepruar në bazë të dispozitës së nenit 370 par. 7 të KPPK-së, pasi që për provat kundërthënëse ka paraqitur në mënyrë të plotë dhe të qartë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i merr si të provuara apo të paprovuara, duke e dhënë vlerësimin për provat kundërthënëse.”

17. Sa i përket vërtetësisë së provave mbi bazën e të cilave parashtruesi i kërkesës është shpallur fajtor, në pjesën përkatëse të Aktgjykit të Gjykatës së Apelit theksohet se:

“Gjykata e shkallës së parë me të drejtë iu ka falur besimin provave të administruara, ku nga dëshmitë e dëshmitarëve GT, FH, HR, MT, MI dhe SI, si dhe të dëmtuarit GN, ka vërtetuar se në ngastrën kadastrale të cilën e ka blerë i pandehuri Svetislav ka ekzistuar varri, dhe këtë e pohon edhe dëshmitari Milija Ivanović, i cili thekson se varri ka ekzistuar që nga lufta e dytë botërore, se i njëjti nuk është dëmtuar as nga përmbytja e vitit 1979, as nga lufta e fundit dhe se varri ka qenë i vendosur në një vend të dukshëm dhe i rrethuar me gurë te koka dhe këmbët në lartësi prej 50 cm, si dhe përreth në lartësi prej 20 cm, dhe në distancë nga rruga diku rreth 6-8 metra. Pretendimet se i pandehuri nuk ka pasur dijeni se në ngastrën të cilën e ka blerë ekziston varri, sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë janë të pabazuara dhe paraqiten me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale. Ky fakt është vërtetuar në mënyrë të plotë nga dëshmia e dëshmitarit MM, policot nga stacioni policor në Shtërpçë, i cili në shqyrtimin gjyqësor deklaroi se “pala e dëmtuar i ishte drejtuar të pandehurit me kërkesë që t’ia lejojë ngritjen e përmendores mbi varrin e të ndjerit, por i pandehuri këtë e ka kundërshtuar dhe i ka lënë një afat prej 10-15 ditësh për të kryer zhvarrimin me shpenzimet e tij, dhe nëse nuk gjen asgjë duhet t’ia kompensojë dëmet e shkaktuara, si dhe që në vendin e ngjarjes i ka gjetur pllakat e vjetra të gurit të cilat janë gjetur para shkallëve të objektit të ndërtuar”, se i pandehuri ka ditur me siguri për ekzistencën e varrit dhe se veprimet e veta i ka ndërmarr pa autorizim gjatë gërmimit dhe rrënimit të varrit me vullnet dhe plotësisht i vetëdijshëm për rrënimin e varrit ku ka qenë i varrosur i ndjeri Asllan. Gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar këtë në mënyrë të plotë nga dëshmia e të dëmtuarve dhe dëshmitë e dëshmitarëve, si dhe nga vetë mbrojtja e të pandehurit, si dhe nga provat tjera të cilat gjenden në

shkresat e lëndës. Prandaj, përfundimet e nxjerra nga gjykata e shkallës së parë si të drejta dhe të ligjshme i pranon edhe kjo gjykatë”.

18. Sa i përket proporcionalitetit të dënimit të parashtruesit të kërkesës, në pjesën përkatëse të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit theksohet:

“Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të këtij lloji dhe kohëzgjatja e dënimit mori parasysh dhe vlerësoi të gjitha rr Ethanat, në pajtim me nenin 75 të KPRK-së, dhe si rr Ethanë lehtesuese mori moshën e të dënuarit, sjelljen e mirë në gjykatë gjatë procedurës në seancë gjyqësore. Si rr Ethanë rënduese gjykata mori ndjeshmërinë e rastit dhe se familja e të dënuarit kishte humbur çdo gjurmë të eshtrave të të ndjerit, si dhe shkallën e rrezikut, i cili kërkon mbrojtje ligjore. Kjo gjykatë vlerëson se në prani të rr Ethanave të lartpërmendura, dënim i cili i është shqiptuar të pandehurit nga gjykata e shkallës së parë i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë penale të të pandehurit, si dhe me intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe se me këtë dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, që është edhe qëllimi i dënimit i përcaktuar me dispozitë ligjore”.

19. Më 3 shtator 2015, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë në Gjykatën Supreme të Kosovës pér mbrojtje të ligjshmërisë. Parashtruesi i kërkesës pretendonte se kishte pasur shkelje të së drejtës materiale dhe procedurale nga gjykatat e shkallëve më të ulëta dhe propozoi ndryshimin e aktgjykimeve të kontestuara, shfajësimin nga përgjegjësia kriminale dhe kthimin e rastit në gjykatë pér rishqyrtim. Parashtruesi i kërkesës u ankua kryesisht që: (i) gjykatat e shkallëve më të ulëta nuk e morën parasysh lejen e ndërtimit që i ishte lëshuar atij nga organet përkatëse komunale dhe (ii) gjykatat e shkallëve më të ulëta nuk e morën parasysh faktin se parashtruesi i kërkesës ndodhej jashtë territorit të Kosovës në kohën kur ishte kryer vepra penale në fjalë.
20. Më 10 nëntor 2015, Gjykata Supreme me Aktgjykimin Pml. nr. 217/2015, e refuzoi si të pabazuar kërkesën pér mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës kundër vendimeve të gjykatave të shkallëve më të ulëta. Gjykata Supreme i pranoi arsyetimet dhe gjetjet e gjykatave të shkallëve më të ulëta në këtë rast penal.
21. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës lidhur me lejen e ndërtimit që i ishte lëshuar atij nga organet kompetente, në pjesën përkatëse të aktgjykimit theksohet:

“Është e vërtetë se në shkresat e lëndës gjenden edhe ato dokumente të bashkangjitura nga mbrojtësi i të gjykuarit, kundërshtimi ndaj provave të administruara, kërkesa pér hedhen poshtë të aktakuzës, si dhe leja ndërtimore pér të cilën në bazë të shkresave thuhet se është dorëzuar bashkangjitur me kërkesën, por në asnjë moment, as i gjykuari, as mbrojtësi, gjatë procedurës provuese nuk kanë propozuar që ky dokument duhet të shqyrtohet. Dispozita e nenit 361 të KPPK-së përcakton se gjykata e bazon vendimin e vet vetëm në faktet dhe provat e proceduara gjatë

procedurës. Në rastin konkret, nga shkresat e lëndës shihet se për pretendimin e lartpërmendur nuk ka ekzistuar propozimi se ai duhet të shqyrtohet, dhe si i tillë ai bëhet i pabazuar”.

22. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës që ai ndodhej jashtë territorit të Kosovës në kohën kur ishte kryer vepra penale, në pjesën përkatëse të aktgjykimit theksohet:

“Në këtë çështje juridike me asnje provë të shqyrtuar nuk mund të vihet në dyshim përgjegjësia penale, sepse është vërtetuar padyshim se i gjykuari Svetislav Stojković në kohën kur filluan punimet – gërmimet ka qenë i pranishëm në fshatin Biti dhe ai e dinte se në afersi të objektit gjendet varri i cili ka ekzistuar edhe pas luftës së dytë botërore dhe për të cilën kanë dëshmuar të gjithë dëshmitarët, madje edhe ata të propozuar nga mbrojtja. Dëshmitari GT ka qenë personi i fundit i cili e ka parë varrin në afersi të vendit dhe i cili ka marrë pjesë në gërmimet e themelit për objektin i cili ishte duke u ndërtuar. Ai ka deklaruar se i gjykuari i kishte thënë ta rrafshojë varrin, por ai e refuzoi këtë dhe menjëherë pas kësaj e shkëputi kontratën për vazhdimin e ekzekutimit të punimeve. Që i gjykuari ka pasur dijeni për ekzistencën e varrit, e ka konfirmuar edhe dëshmitari MM, polic në SP në Shtime, i cili, siç kishte deklaruar, e ka kryer rolin e ndërmjetësuesit mes palëve, ka biseduar me të gjykuarin Svetislav rrëth varrit dhe zhvendosjes së tij eventuale në një lokacion tjeter për të cilën i gjykuari i kishte lënë palës së dëmtuar afatin prej 15 – 30 ditësh. Kjo ka ndodhur në vitin 2012 kur kanë filluar punimet në afersi të vendit ku gjendej varri, ndërsa më datën 20 mars 2013, dëshmitari-i dëmtuari GN ka paraqitur një kërkesë për zhvendosjen e mbetjeve mortore të gjyshit të tij sipas marrëveshjes me të gjykuarin, dhe pastaj ka shkuar për të vizituar varrin në fshatin Biti, ku ka vërejtur se në lokacionin kontestues është ndërtuar objekti dhe se varri më nuk është aty. Ai menjëherë e ka lajmëruar rastin në polici. Domethënë, të gjitha këto tregojnë se i gjykuari ka pasur dijeni për ekzistencën e varrit dhe se përkundër kësaj ai i ka vazhduar dhe përfunduar punimet ndërtimore edhe pse, pavarësisht nga posedimi i lejes ndërtimore, nuk kishte të drejtë, as nuk ka guxuar t'i fillojë punimet ndërtimore pa i përbushur paraprakisht procedurat ligjore në lidhje me zhvendosjen e mbetjeve mortore. Për këtë arsy, konstatimet juridike e të dyja gjykatave janë të drejta dhe të ligjshme, dhe si të tilla i pranon edhe kjo Gjykatë”.

Pretendimet e parashtruesit te kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 24 [Barazia Para Ligjit], nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa).
24. Sa i përket shpalljes fajtor, parashtruesi i kërkesës pretendon se: “Kundër kësaj aktakuze, parashtruesi i kërkesës paraqiti Kërkesën për hedhjen poshtë të aktakuzës, në të cilën theksoi se në paluajtshmërinë kontestuese e cila është në pronësi të tij private nuk gjendet asnje varr apo përmendore mbivarrore, as ndonjë vend i cili mund t'i ngjajë një varri. Ai theksoi se ngastrën e ka blerë

nga fqinji i cili nuk e kishte njoftuar se aty dikur gjendej ndonjë varr. Pastaj, theksoi se më datën 10.07.2012 nga organet kompetente të Komunës së Shtërpcës e ka marrë në mënyrë të rregullt lejen ndërtimore për ndërtimin e motelit, gjithashtu theksoi se gjatë kryerjes së pretenduar të veprës penale ka qenë në Zvicër dhe se fare nuk ka qenë në Kosovë, d.m.th. në vendin e kryerjes së veprës penale”.

25. Sa i përket lejes së ndërtimit, të lëshuar nga organi kompetent, parashtruesi i kërkesës pretendon se: “*kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Dega në Shtërpcë, më datën 20.01.2015, paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës nga të gjitha arsyet ligjore, duke theksuar veçanërisht faktin se në gjykatën e shkallës së parë kishte paraqitur si prova: certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme, lejen e ndërtimit nga e cila shihet se Komuna e Shtërpcës ia kishte lëshuar parashtruesit të kërkesës lejen ndërtimore për ndërtimin e objektit në ngastrën në të cilën kinse gjendej një varrezë, vërtetimin nga Departamenti i Urbanizmit të Komunës së Shtërpcës me të cilin komuna vërteton se nuk ka asnje interes në lidhje me ngastrën në fjalë. Në ankesë konstatoi se gjykata e shkallës së parë ka dështuar t'i administrojë provat e propozuara dhe si rezultat i vërtetimit të tillë të gjendjes faktike e ka shkelur edhe të drejtën materiale në dëm të të akuzuarit*”.
26. Sa i përket mundësisë që parashtruesi i kërkesës të përcjellë procedurat në gjuhën e tij amtare, parashtruesi i kërkesës pretendon se: “*Ai, gjithashtu, theksoi se nuk ka pasur mundësi për të ndjekur e tërë rrjedhën e procedurës së shkallës së parë në gjuhën e vet. Më datën 25.05.2015, Gjykata e Apelit e Kosovës mori aktgjykimin me të cilin është refuzuar ankesa e të akuzuarit, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar*”.
27. Sa i përket drejtësisë së procedurave në Gjykatën Supreme, parashtruesi i kërkesës pretendon se: “*Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, mbrojtësi i të akuzuarit, më datën 09.09.2015, paraqiti mjetin e jashtëzakonshëm juridik – “Kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërise”, në të cilën theksoi faktin se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë janë marrë si rrjedhojë e shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, për shkak se as gjykata e shkallës së parë, as gjykata e shkallës së dytë, gjatë procedurës nuk e kishin administruar si provë: Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme për ngastrën kadastrale nr. 1458 ZK Biti e Poshtme, lejen ndërtimore të lëshuar nga Komuna e Shtërpcës, vërtetimin e Komunës së Prishtinës me të cilin vërtetohet se komuna nuk ka asnje interes në lidhje me këtë ngastër. Është propozuar që të dyja aktgjykimet të anulohen dhe i pandehuri të lirohet nga përgjegjësia penale. Më datën 10.11.2015, Gjykata Supreme e Kosovës mori aktgjykimin Pml - nr. 217/2015, me të cilin e refuzoi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërise*”.
28. Përfundimisht, parashtruesi kërkon nga Gjykata që të anulojë vendimet e lëshuara nga gjykatat e rregullta.

Pranueshmëria e kërkesës

29. Gjykata së pari do të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

31. Gjykata po ashtu i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

32. Gjykata, më tutje, merr parasysh rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës, i cili parasheh se:

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

...

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

33. Gjykata vëren se në rastin e tanishëm, parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të të drejtave dhe lirive të tij të garantuara me Kushtetutë dhe Konventë, sepse gjykatat e rregullta nuk e kanë lejuar atë të përcjellë procedurat në gjuhën e tij amtare, argumentet dhe provat e paraqitura nga ai nuk janë marrë në konsideratë nga gjykatat e rregullta dhe vërtetësia e provave në të cilat është bazuar fajësia e tij nuk ishte konfirmuar nga gjykatat e rregullta.

34. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës se ai nuk ka mundur të ndjekë procedurat në gjuhën e tij amtare, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit ka shpjeguar që parashtruesi i kërkesës kishte nënshkruar procesverbalin, duke vërtetuar se ai kishte qenë në gjendje t'i përcjellë procedurat në Gjykatën Themelore në gjuhën e tij amtare dhe se në atë kohë ai nuk kishte pasur ndonjë vërejtje lidhur me atë pretendim.

35. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës se ai nuk ka qenë në gjendje t'i ndjekë procedurat në gjuhën e tij amtare, Gjykata vëren se Gjykata Supreme ka shpjeguar që parashtruesi i kërkesës nuk kishte paraqitur provë të tillë para Gjykatës Themelore gjatë procedurës së konfirmimit dhe se në këtë aspekt, gjykatat e rregullta janë të obliguara me ligj që të vlerësojnë vetëm provat që paraqiten para tyre për shqyrtim.

36. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës në lidhje më vërtetësinë e provave në të cilat është bazuar fajësia e tij, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit ka shpjeguar që, bazuar në dëshmitë e dëshmitarëve, duke përfshirë edhe ato të propozuara nga parashtruesi i kërkesës dhe prova të tjera materiale, parashtruesi i kërkesës ishte i vetëdijshëm se ai kishte vepruar pa autorizim, domethënë, që kishte kryer vepër penale.
37. Në dritën e shqyrtimeve të mësipërme, Gjykata përsërit që parashtruesi i kërkesës ka pasur dobi nga procedurat kundërshtuese; ka mundur që në fazë të ndryshme të paraqesë argumente dhe prova që i konsideronte relevante për rastin e tij; që e ka pasur mundësinë që në mënyrë efektive të kontestonte argumentet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtuese; që të gjitha argumentet e tij, që në pikëpamje objektive, ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tij, ishin dëgjuar dhe shqyrtuar në mënyrë të duhur nga gjykatat; që arsyet ligjore dhe faktike për vendimet e kontestuara ishin përcaktuar në hollësi; dhe që në përputhje me rrëthanat, procedurat në tërësi ishin të drejta (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aplikimi nr. 30544/96, [GC], Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 29).
38. Duhet marrë parasysh, meqë ky është një burim i shpeshtë i keqkuptimeve mes palëve, që "drejtësia" e kërkuar nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës nuk është drejtësi "përbajtësore" (një koncept që është pjesërisht ligjor, pjesërisht etik dhe mund të aplikohet vetëm nga gjyqtari i çështjes), por është drejtësi "procedurale". Në aspektin praktik kjo kuptohet si procedurë e kundërshtimit në të cilën parashtrimet dëgjohen nga palët dhe në të cilën palët janë të barabarta para Gjykatës (Shih rastin *Star Cate – Epilekta Gevmata dhe të tjerët kundër Greqisë*, Aplikacioni nr. 54111/07, ECtHR, Vendimi i 6 korrikut 2010).
39. Sa i përket pranueshmërisë së provave, Gjykata përsërit që përderisa neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës garantojnë të drejtën për gjykim të drejtë, ata si të tillë nuk përcaktojnë ndonjë rregull mbi pranueshmërinë e provave e që sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë, është çështje e ligjshmërisë. Në mënyrë të veçantë, nuk është detyrë e Gjykatës të merret me gabimet e ligjit apo fakteve, që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta përvëç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (Shih rastin *Schenk kundër Zvicrës*, [GC], Aplikacioni nr. 10862/84, Aktgjykimi i 12 korrikut 1988, faqet 45-46).
40. Në këtë drejtim, Gjykata përsërit që parashtruesi i kërkesës vetëm i citon dispozitat e Kushtetutës dhe të Konventës, pa sqaruar se si janë shkelur ato norma dhe dispozita kushtetuese në dëm të tij, sikurse kërkohet me nenin 48 të Ligjit.
41. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose ligjit që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave ose gjatë aplikimit të ligjit (ligjshmërisë), përvëç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëri) (Shih, për shembull, rastin nr. KI89/15, parashtrues *Fatmir Koci*, Aktvendim për papranueshmëri i 22 marsit 2016, paragrafi 38).

42. Në fakt, është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të aplikojnë rregullat përkatëse të së drejtës materiale dhe procedurale (shih, *mutatis mutandis*, *García Ruiz kundër Spanjës [GC]*, nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
43. Gjykata Kushtetuese rikujton se nuk është Gjykatë e gjetjes së fakteve dhe në këtë mënyrë vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, ndërsa roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, prandaj, nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (shih *rastin Akdivar kundër. Turqisë*, nr. 21893/93, ECtHR, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, paragrafi 65, dhe po ashtu shih *rastin mutatis mutandis*, rasti KI86/11, të parashtruesit *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 prillit 2012).
44. Fakti se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë vetveti një pretendim të argumentuar për shkelje të nenit 24 dhe 31 të Kushtetutës dhe nenit 13 të Konventës (Shih, për shembull, rastin nr. KI125/11, *Shaban Gojnovci*, Aktvendim mbi papranueshmëri i 28 majit 2012, paragrafi 28).
45. Në këto rrethana, Gjykata konsideron që parashtruesi i kërkesës nuk i ka dëshmuar pretendimet e tij për shkelje të të drejtave themelore të njeriut siç garantohen me Kushtetutë dhe me Konventë. Faktet e rastit nuk tregojnë që gjykatat e rregullta kanë vepruar në kundërshtim me garancitë procedurale të përcaktuara me Kushtetutë dhe Konventë.
46. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, dhe specifikohet më tej me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) (d) të Rregullores së punës, më 20 tetor 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari rapportues

Ivan Čukalović



The seal of the Constitutional Court of Kosovo is circular. It features a central figure holding scales and a sword, surrounded by the text "REPUBLIKA E KOSOVËS", "GJYKATA KUSHTETUËSE", "CONSTITUTIONAL COURT", and "REPUBLIC OF KOSOVO".

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi